



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike

Tiranë, më 28 Shtator 2024

Lënda: Informacion mbi tentativën për të intimiduar me rrethana të rreme një deputet të Kuvendit të Shqipërisë.

Drejtuar: **Z. Altin DUMANI**
Drejtues i Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar

Për dijeni: **Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë**
Delegacionit të Bashkimit Europian në Tiranë
Ambasadës së Mbretësisë së Bashkuar në Tiranë

I nderuar Z. Drejtues i Prokurorisë,

Më datë 28 Shtator 2024, ora 20:22, në platformën e komunikimit tim “Signal”, në telefonin tim personal, nga një numër i paidentifikuar, me emër përdoruesi “Mbreti Zog”, janë dërguar disa mesazhe elektronike, dokumente qartazi të falsifikuara, emrat e dy shtetasve të përmendur në media si të përfshirë në krimin e organizuar, njëri prej të cilëve i shpallur në kërkim nga Prokuroria e Posaçme dhe një tjetër i mbetur i vrarë në një atentat në Tiranë, shoqëruar me “urimin” – “të jesh mirë”. Këtyre mesazheve i është vendosur nga dërguesi një kohëzgjatje fshirje prej 1 jave, me qëllim humbjen e mëpasme të tyre.

Duke vlerësuar përmbajtjen e këtyre mesazheve dhe dokumentit bashkëlidhur, që qartazi me sy të lirë dallohet se është i sajuar, çmuj të nevojshme t’ju informoj se për mua këto komunikime janë një tentativë për të më intimiduar në ushtrimin e detyrës time si deputet i Kuvendit të Shqipërisë dhe njëkohësisht Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, grupit parlamentar më të madh të opozitës në vend. Përmbajtja e mesazheve të dërguara, sajimi i rrethanave dhe fakteve të pandodhura, ndërlidhja e emrit tim me individë krejtësisht të panjohur prej meje, synon frikësimin tim për të mos përballur me fakte konkrete të paligjshmërisë subjekte të posaçme apo eksponentë të krimit të organizuar, që janë nën hetim apo verifikim nga Prokuroria e Posaçme Kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit.

Këto mesazhe intimiduese dhe me përmbajtje tërësisht të rreme vijnë pas seancës plenare të datës 12 Shtator 2024, ku gjatë një interpelance me Kryeministrin e Shqipërisë Edi Rama, unë në cilësinë e deputetit të Kuvendit të Shqipërisë e përballa atë me disa të dhëna të platformës SKY/ECC që janë bërë publike, si dhe e paralajmërova se shumë shpejt do ta përballë me të dhëna të tjera të të njëjtës natyrë që provojnë lidhjet mes funksionarëve të lartë publik dhe krimit të organizuar, gjithmonë pa cenuar dhe duke respektuar rregullat për ruajtjen e sekretit hetimor.

Ju jeni në dijeni të faktit se personalisht nga ana ime, apo në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, unë kam denoncuar pranë jush zyrtarë të lartë publik, familjarë të tyre, eksponentë të krimit të organizuar, apo lidhjet ndërmjet tyre. **Kjo ngre dyshimin e arsyeshëm që pas tentativës për intimidimin tim apo dërgimit të këtyre mesazheve, janë subjekte që hetohen nga Prokuroria që ju drejtoni (eksponentë të krimit të organizuar apo zyrtarë të lartë publikë).**

Nga ana tjetër, përmes falsifikimit të një dokumenti që supozohet të jetë nën administrimin tuaj apo i atribuohet institucionit tuaj, qartazi synohet edhe diskretitimi i Prokurorisë që ju drejtoni, duke qënë se dokumente të kësaj natyre mund të gjenden vetëm në dosjet në hetimin nga ana juaj. Në këtë kuptim, verifikimi/hetimi i këtij rasti, është jo vetëm në interesin tim për të zbuluar autorët dhe motivet e tyre, por edhe për të ruajtur reputacionin dhe kredibilitetin e institucionit tuaj.

Përsa më lart, kërkoj bashkëpunimin tuaj për të hetuar dhe verifikuar në një kohë të shpejtë mesazhet me natyrë intimiduese ndaj një deputeti të Kuvendit të Shqipërisë, me qëllim identifikimin e autorit/ëve të këtyre mesazheve, motiveve të dërgimit të tyre, dhe arsyet e prodhimit të një dokumenti të falsifikuar. Gjithashtu, për qëllime publike ju nxis të verifikoni edhe përmbajtjen e rrethanave konkrete të tyre.

Bashkëlidhur ju dërgoj përmbajtjen e mesazheve intimiduese, duke shprehur gadishmërinë time për tu vënë në dispozicionin tuaj menjëherë për verifikimin e plotë të rrethanave të këtij rasti, duke rikujtuar kohën e shkurtër që dërguesi ka vendosur (1 javë) për fshirjen e përmbajtjes së tyre.

Me respekt,

KRYETARI I GRUPIT PARLAMENTAR TË PARTISË DEMOKRATIKE

Gazment BARDHI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER MIMOZA SADUSHAJ



V2024053540324488400

DATE 29/09/2024
NR REP 5086

PROÇESVERBAL I DOKUMENTIT ELEKTRONIK



Sot, më datë 29/09/2024 (dymijë e njëzet e katër), përpara meje Zv.Notere Ina Papa, në bazë të autorizimit me Nr.12 Prot., datë 24.09.2024 dhe në bazë të urdhërit të emërimit me Nr.3950/1Prot., datë 16.06.2023 lëshuar nga Ministria e Drejtësisë, me zyrë në adresën Tiranë, Rruga Vaso Pasha, pallati 13/1 Tiranë, u paraqit personalisht:

KËRKUESI: Gazment Bardhi, atësia Durim, amësia Vjollca, shtetas Shqiptar, lindur në Kavajë, Durrës dhe banues në KAVAJË, me adresë Besim Sinella 04040027; Nd. 1; H. 1; Kavajë; Kavajë; 2501; Kavajë, lindur më 06/07/1986, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me pasaportën biometrike me nr. BR3876143 dhe nr. personal I60706024V.

Unë, Zv. noterja Ina Papa, sot më datë 29.09.2024, në prani të kërkuarit hapa telefonin e tij celular dhe aksesova aplikacionin "Signal", me numër telefoni +355 67 20 59 911. Komunikimi i fundit rezultoi me përdoruesin "Mbreti Zog", pa numër të identifikuar. Pasi hapa këtë komunikim rezultoi se ditën e djeshme, datë 28.09.2024, ora 20:22, përdoruesi "Mbreti Zog" ka dërguar një mesazh, në përmbajtje të cilit ndodhen dy imazhe të një dokumenti, të shoqëruar me tekstin sipas print screen-it (bashkëlidhur përmbajtja e mesazhit).

Ky komunikim është printuar dhe i bashkëlidhet këtij procesverballi.

Unë Zv.noterja në bazë të nenit 62, shkronja "k", të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", vërtetoj se komunikimi i printuar, është i njëjtë me atë që ndodhet në komunikimin elektronik në aplikacionin "Signal" të kërkuarit.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Zv.Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të kërkuarit të këtij dokumenti, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

KËRKUESI:

Gazment BARDHI

Gazment Bardhi

ZËVËNDËSNOTERE

INA PAPA




NOTER
TYRANE

M

Mbreti Zog >

Yesterday

🕒 Unknown set disappearing message time to 1 week.



Elvis Martini , Erigers Mihasi

20:22 🕒

Te jesh mir 20:22 🕒

🔒 You accepted the message request.

Options

Ca thua? Me verte eee 😄😄😄 20:25 🕒 🔄